



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 29 janar 2016, në mbledhjen e XXV-të (njëzetepesë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Bashkim Statovcit i cili mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe, z.Agim Veliu Kryetar i Komunës, z.Nexhmi Rudari Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përshëndeti të pranishmit, she shtoi, konsideroj se thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë duke përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur një ditë më parë. E hapi diskutimin, dhe nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës së bashku edhe me Konstatimet nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 28 janar 2016.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 30 dhjetor 2015

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua Ekstrakti i procesverbalit.

3. Propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal – SZHEL për periudhën 2016 – 2018

-Vendimi për vënie në diskutim publik

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo pikë ka qenë e paraparë edhe në planin e punës së Kuvendit, Ekzekutivi i Komunës i është përmbajtur kësaj, andaj për më shumë, fjalën ja jap drejtorit të Drejtorisë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të bëjë një prezantim të draft Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2016 – 2018.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe i autorizuar për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, në fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, kam kënaqësinë që para juve ë paraqesë draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për vitet 2016-2018, Strategji kjo e punuar në koordinim me kompaninë Management and Development Associates (MDA) nën mbikëqyrjen e Grupit punues në krye me Kryetarin e Komunës z.Agim Veliu, Nënkryetarin e Komunës dhe zyrtarët tjerë nga Ekzekutivi i Komunës. Në këtë draft Strategji, jemi përqendruar të paraqesim prioritetet dhe masat konkrete për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm lokal duke u bazuar edhe në mundësit buxhetore që ka Komuna e Podujevës, përkatësisht jemi përqendruar edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore, pra nuk kemi paraqitur projekte të cilat në të ardhmen mund të jenë si fontanë dëshirash, mirëpo janë paraqitur projekte të cilat janë të realizueshme dhe që kanë përputhshmëri me buxhetin. Fillimisht është bërë vlerësimi i gjendjes aktuale duke mbledhur të dhënat sasiore dhe cilësore si brenda Komunës ashtu edhe në terren, për të vazhduar mandej me një ekzaminim sektorial ku përmes pyetësorëve dhe intervistave të realizuara me drejtor të Drejtorive dhe shefa të sektorëve përkatëse ku janë nxjerrë prioritetet dhe masat konkrete për secilën Drejtori veç e veç dhe si rezultat i kësaj ka buruar edhe Strategjia të cilën e keni para vetes. Është bërë edhe hulumtimi sekondar ku janë marrë edhe Strategjitë e mëparshme dhe Strategjitë tjera të cilat janë të ndërlidhura me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe është pasqyruar profili i shkurtër i Komunës së Podujevës duke paraqitur pasuritë dhe burimet natyrore, gjendjen e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, infrastrukturës, shërbimeve publike dhe të tjera, për tu koncentruar me përkushtimin tonë më të madh tek plani strategjik ku përmes misionit dhe vizionit i kemi paraqitur edhe prioritetet e qarta për secilën Drejtori dhe masat konkrete që do të ndërmerren dhe kemi konkretizuar planin operacional se si do të realizohen projektet e caktuara. Për të përmbyllur këtë pjesë me amzën e projekteve përkatësisht e kemi paraqitur Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe projektet e paraqitura në këtë dokument janë të mbuluara me buxhet dhe disa të tjera janë të parapara me donatorë të mundshëm. Ajo që më së shumti e pasuron këtë Strategji është edhe harta interaktive e cila është pjesë përbërëse e kësaj Strategjie, *(paraqitet në formë elektronike me anë të projektorit)*, hartë e cila paraqet të dhënat rrethë popullsisë, grupmohave, infrastrukturës, rreth gjendjes së bujqësisë, pylltarisë, mirëqenies sociale e të tjera, po ashtu kjo hartë është mjaft e rëndësishme për vet Ekzekutivin e Komunës pasi që mund të bëhet planifikimi edhe më i qartë rreth zhvillimit ekonomik lokal, është e dobishme për vet këshilltarët e Kuvendit por edhe për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës e veçanërisht është e rëndësishme për investitorët potencial sepse me anë të kësaj ofrohen të dhëna të mjaftueshme për

secilin lokalitet, pra mjafton të klikohet njëherë dhe paraqiten të gjitha të dhënat dhe kjo është proces dhe nuk do të thotë se nuk do të pasurohet me të dhëna tjera shtesë.

Jemi të vetëdijshëm se në këtë draft dokument mund të ketë lëshime ose gabime eventuale, por ne i mirëpresim të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo plotësimet e juaja, mirëpo edhe ato nga debati publik me qytetarë që do të mbahet rreth këtij dokumenti duke shpresuar dhe besuar se dokumenti final do të jetë më i miri i mundshëm.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj drejtorin parafolës për prezantimin e draft Strategjisë, para se të hapë debatin ju njoftoj se nga drejtori parafolës është propozuar që debati publik me qytetarë të mbahet më 05 shkurt 2016 ku janë të mirëseardhur të gjithë këshilltarët e Kuvendit e që është edhe obligim i tyre, por të mirëseardhur janë edhe të gjithë qytetarët pa dallime ku të gjitha vërejtjet, plotësime ndryshimet dhe sugjerimet e tyre janë të mirëseardhura dhe do të trajtohen me kujdes. Vlen të ceket se drafti i Strategjisë është në diskutim publik 2 muaj ku besoj se do të pasurohet edhe më shumë nga ky diskutim.

z.Fidan Rekalu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë draft Strategji për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2016-2018 për Komunën e Podujevës, mendojmë se është një Strategji e cila do të ndikon në zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës dhe për këtë vlen të përhëndetet Ekzekutivi i Komunës së Podujevës në krye me Kryetarin e Komunës z.Agim Veliu, për hartimin dhe punimin e kësaj draft Strategjie. Ajo çka është më e rëndësishme e që edhe drejtori parafolës e ceku është se ky dokument është vetëm një draft për të cilin kemi mundësi të japim vërejtje, plotësime dhe sugjerime tona për t'i futur në kuadër të kësaj Strategjie, mundësi të cilën do ta kenë të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës në debatin publik i cili u propozua të mbahet me 05 shkurt 2016. Pra ne si Grup e përkrahim edhe çdo Strategji tjetër e cila do të ndikon në zhvillimin ekonomik të Komunës së Podujevës.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, në fakt pavarësisht vendimit që do të merret sot këtu, data e debatit publik që do të mbahet me qytetarë veç është caktuar ashtu siç e ceku Kryesuesi i Kuvendit, por sido që të jetë është paraqitur draft dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal i cili është dokument bazik i planifikimit dhe vrojtimit zhvillimorë për Komunën e Podujevës, prandaj unë kam shpresuar që sot të mos jetë kjo seancë veç formale por të jetë mundësi e diskutimit dhe ballafaqimit të ideve sepse pavarësisht dallimeve tona politike dhe konceptuale zhvillimi ekonomik i Komunës dhe ngritja e mirëqenies së qytetarëve është pika e cila do të duhej të na bashkonte si objektiv i përbashkët i secilit prej nesh, por a është në të vërtetë ky dokument udhërrëfyes i zhvillimit të qëndrueshëm, me keqardhje më duhet të konstatoj se kjo Strategji është jo serioze, është jo profesionale dhe si e tillë është e papranueshme. Ajo që e bënë këtë draft Strategji të papranueshme është mungesa e profesionalizmit në hartimin e një dokumenti strategjik, mos përcaktimi i saktë i afatit kohor të realizimit sepse thirrja është 2015-2018 kurse dokumenti është 2016-2018, bartja apo përmbledhja e informacioneve, mos pasja e vizionit, objektivave dhe planit serioz operacional të zbatimit dhe para së gjithash ky dokument nuk mund të jetë rrugëtimi ynë i përbashkët drejt zhvillimit dhe mirëqenies, dhe si tillë ky dokument nuk mund të quhet Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal, por mund të quhet profil i Komunës apo përmbledhje e pasaktë e historikut të Komunës, KAB-it dhe disa të dhënave jo relevante nga disa autorë si dhe guida turistike. Këto arsye janë të mjaftueshme që të kërkohet ribërja e një dokumenti më profesional, më gjithëpërfshirës, më serioz që do të hapte rrugë zhvillimit të qëndrueshëm dhe për rrjedhojë rritjes së

mirëqenies së qytetarëve dhe gamës së shërbimeve komunale, prandaj para se të kalohet në diskutim publik dokumenti si i tillë mendoj se duhet të ribëhet nga një trup punues që do të përfshinte Ekzekutivin e Komunës, ekspertët e fushave, gjithë spektrin politik, grupet e interesit dhe shoqërinë civile, e them këtë sepse ky dokument ka shpërputhje të shumave financiare në krahasim me buxhetin e konsoliduar të Kosovës të ndarë për Komunën e Podujevës dhe në krahasim me Kornizën Afatmesme Buxhetore për të njëjtën periudhë. Dokumenti si i tillë nuk përcakton kapacitetin zhvillimorë, zonat funksionale qoftë turistike, turizmin rural, bujqësisë, blegtorisë, shërbimeve, zonave ekonomike dhe të prodhimit. Strategjia lenë shërbimet në gjendjen ekzistuese duke i trajtuar jo seriozisht në ngritjen e kapaciteteve dhe digjitalizimit duke mos u dhënë zgjidhje qendrave të mëdha administrative si, Orllanit, Kërpimehut, Lluzhanit dhe Dumnicës, Strategjia në pjesën më të madhe parasheh objektiva të cilat dalin si obligime të përditshme ligjore, shembull, bartja e nxënësve, inventarizimi dhe gjendja e tyre, vlerësimi i performancës të drejtorëve të shkollave, vlerësime të performancës komunale e të tjera. Pastaj zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor, kjo Strategji e sheh si investim kapital, një objekt rekreativ sportiv. Ky dokument pavetëdijshëm tallet me Ekzekutivin e Komunës sa i përket ngjyrave të tabelave të trashëgimisë të cilat i quan tabela të kafta, mandej ky dokument brenda vetës parasheh projekte të realizuara apo në finalizim e sipër, si, objekti i maternitetit, pika grumbulluese në fshatin Sfeqël, renovimi i stadiumit të qytetit etj. projekte të cilat janë të buxhetuara nga Komuna ose të financuara nga donatorët dhe si të tilla parashihen në këtë Strategji, pra kjo Strategji nuk iu paraprinë projekteve por shkon mbrapa tyre. Strategjia tek në vitin 2017 parasheh që Komuna të jetë e gatshme të hyjë në partneritet publiko privat, po ashtu Strategjia nuk përmend askund bashkëpunimin ndërkomunal, binjakëzimin apo forma tjera të bashkëpunimit, gjithashtu dokumenti nuk jep përgjigje të saktë të ngritjes së kapacitetit për furnizim me ujë, dokumenti 43% të resurseve të Komunës që i përbëjnë pyjet nuk i trajton në aspektin zhvillimorë, mandej promovimi i produkteve lokale nuk mund të bëhet vetëm në Ditën e Mjadrës, pastaj investimet nga diaspora nuk mund të arrihen me klube apo takime formale por me projekte serioze që të gjenden mundësitë e zhvillimit. Pra ky dokument mund edhe të quhet profil i Komunës, mund të quhet edhe buletin por në asnjë mënyrë nuk përmbush asnjë nga kriteret e një Strategjie Zhvillimore.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket pikës së tretë të rëndit të ditës propozimi i Strategjisë për Zhvillim Ekonomik lokal, nuk kisha dashtë të ndalem në detaje të hollësishme në këtë pikë pasi shihet mirë një pasqyrë me të dhëna vetëm sa për ti mbushur 40 faqe. në faqen 10 është shkruar se 57% e popullsisë së qytetit tonë është në moshën 30 vjeçare, pra popullsia është më e dendur në grup moshat e reja. Pra e dimë mirë të gjithë se nuk ka kurrfarë strategjie për të rinjtë Llapjan ku kohen e lirë e kalojnë në kafiteri, pastaj moshat 1-5 vjeçare, periudhë kjo që e cila ka nevojë për çerdhe e këtu te ne çerdhes tonë i mungojnë kushtet elementare, duke filluar që prej higjienës, ushqimit jo cilësor, oborrit të pa rregulluar, mungesës së parkingut, gjë që i bën prindërit të obliguar të dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhet private, shtrohet pyetja, pse nuk i rregullojmë këto gjëra pasi që nuk janë edhe aq shumë të kushtueshme, dhe pse nuk ka çerdhe në njërin prej fshatrave të Podujevës pasi kjo gjë është shumë e nevojshme.

Sa i përket klimës, thuhet se Podujeva ka klimë të mesme kontinentale, na intereson të dimë ku është stacioni meteorologjik i Komunës që e mat temperaturën, a është funksional dhe në cilin lokacioni është, dhe pse nuk është cekur. Sa i përket transporti Publik, është cekur se banorët e Podujevës kanë qasje të mirë në transport publik, andaj përse ne i

shohim vetëm autobusët privat si në qytet ashtu edhe në fshatra. Në faqen 23, thuhet se deri në fund të vitit 2018 hartohet master plani për zonën e Liqenit të Batllavës, shtrohet pyetja, master plani për çka, e që nuk është cekur fare, kjo është vetëm sa për të na hedhur hi syve. Në faqen 32, ndërtimi i trotuareve gjatë vitit 2016 në rrugët magjistrale dhe regionale, shtrohet pyetja, pse nuk është cekur cilat rrugë por e njëjta gjë përsëritet edhe në vitin 2018, pra pse gjerat e njëjta rregullohen dy herë, pra këtu po shihet ashiqare për një keq menaxhim, pra siç thuhet në popull rrugët ndërtohen vetëm shkel e shko. Në faqen 15, te trashëgimia kulturore, çka keni bërë ju për trashëgiminë kulturore, pse nuk janë cekur mullinj të e vjetër me ujë, pastaj mulliri i Pashës në Podujevë afër Xhamisë, ku mund të restaurohet dhe të ndërtohet një ambient i bukur dhe i përshtatshëm si monument kulturor apo galeri, pastaj në faqen 24, pse nuk e bëni një gjë të tillë sikurse Gjilani që kopjoj Shpend Ahmetin e vetëvendosjes në Prishtinë, që të bëhen kioske elektronike për dhënien e certifikatave, dhe krejt në fund dua ta bëj edhe një pyetje, pse nuk ka strategji për hapjen e Aeroportit të Dumoshit përderisa Komuna e Gjakovës është duke hapur për udhëtar civil, dhe për këtë pres përgjigje.

z.Flakron Gashi, theksoi, sa i përket kësaj draft Strategjie Zhvillimore unë do të ndalem vetëm tek plani strategjik dhe në këtë aspekt të ngris tri çështje të cilat më kanë shtyrë të hulumtoj më shumë. I nderuari drejtor, njëra prej qëllimeve strategjike është edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe njëra prej pikave është edhe përmirësimi i klimës të bërit biznes, si mendoni ju të përmirësoni klimën e të bërit biznes kur dihet që për investime kapitale shkojnë mbi 5 milion euro dhe pothuajse gjysmën e këtyre projekteve i marrin katër apo pesë kompani të cilat qëndrojnë prapa partisë tuaj. Tek çështja e ngritjes së cilësisë në arsim jo që vetëm këtyre kompanive nuk ju mjafton dhënia e të gjitha tenderëve por madje familjarët e tyre punësohen si të padiplomuar dhe japin mësim në shkollat e mesme. Dhe çështja tjetër si qëllim strategjik është përmirësimi i mirëqenies sociale, më thoni ju si zyrtar komunal, cila është një ëmbëltore, byrektore apo një pastiçeri në Komunën e Podujevës në të cilën nuk pihet ose nuk konsumohet duhani dhe cili është ai familjarë i cili sot mund të nxjerrë fëmijën e vet për të drekuar. Me këtë qasje nuk ka nevojë të nxjerrën dokumente strategjike por mjafton të zbatohen ligjet të cilat janë shumë të qarta dhe përcaktojnë shumë çartë kompetencat e Komunës.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk do të ndalem shumë në këtë strategji sepse pothuajse të gjitha më detajisht i ceku kolegja nga radhët e LVV-së, por megjithatë edhe unë do të jap kontributin tim në disa pika. Sa i përket vizionit i cili është në kuadër të planit strategjik, ku ndër të tjera thuhet, Komuna e Podujevës do të angazhohet për qeverisje efikase, arsim cilësorë, mjedis të pastër, shëndetësi dhe mirëqenie për të gjithë, ambient të përshtatshëm për biznese, bujqësi të zhvilluar dhe ngritje të cilësisë së jetesës, do të thotë deri tani këto kanë munguar apo pse është formuluar kështu. Po ashtu te pika tjetër ndër të tjera thuhet, do të mund të realizohen projekte dhe investime të ndryshme përmes partneritetit publiko privat, andaj pyes, përse nuk ka ndodhur deri më tash dhe pse është pritur 16 vite pas lufte kur kjo ka mund të bëhet edhe më herët. Çështje tjetër që për ne mbetet të marrim përgjigje është edhe funksionalizimi i Zyrës për Diasporë, mendojmë se diaspora nuk është në vitin 2016 por ajo është që një kohë të gjatë dhe mendoj se në këtë drejtim qeveria komunale është dashur të jap një kontribut më të madh e jo të pritët viti 2016.

Të nderuar koleg çështje tjetër të cilën e shoh të arsyeshme të diskutojmë është edhe turizmi, në këtë plan të strategjisë pothuajse aspak nuk i kushtohet rëndësi turizmit ndonëse nëpër fushata shpeshherë përmendet se Komuna e Podujevës e ka një ambient të

përshtatshëm për zhvillimin e turizmit kurse në këtë plan strategjik gjë për të cilën pres përgjigje nga udhëheqësi apo menaxheri i këtij projekti. Çështja tjetër është tek hidrologjia, ndonëse vetëm formalisht jepet gjatësia dhe gjerësia e lumit Llap, në këtë drejtim nuk kemi ndonjë projekt të specifikuar që banorët do t'i gëzoheshin e që unë mendoj se ka kushte të mira që Komuna jonë të ngritë fabrika të vogla të ujit, por kjo si ide mungon nga qeveria komunale. Pastaj çështje tjetër është edhe tek pasuria nëntokësore, ndonëse në dokument ceket edhe një nga pasurit e Komunës, Çuka e Batllavës apo siç quhet në popull Çuka e Drazhnjes, megjithatë nuk ka ndonjë projekt të detajuar që qytetarët do të mund të presin ndonjë punësim në atë drejtim. Për të gjitha këto mendojmë se është mirë që qeveria komunale, Ekzekutivi i Komunës, drejtori i Drejtorisë përkatëse dhe i gjithë ekipi që ka punuar në këtë dokument, t'i merrë për bazë në mënyrë që qytetarët në të ardhmen të presin rezultate të mira nga kjo strategji. E kam përmend disa herë dhe po e përsërisë se nuk është mirë që të kemi vetëm në letër plane apo strategji të ndryshme por është mirë që të zbatohen edhe në praktikë.

z.Hasan Softolli, theksoi, propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal për periudhën 2016-2018 përbën një dokument shumë të rëndësishëm për Komunën e Podujevës sepse në bazë të këtij dokumenti apo siç quhet ndryshe plan strategjik, Ekzekutivi i Komunës ka vendosur kornizat dhe vijat e prioriteteve që janë me të lehta për orientim dhe zhvillim. Vizioni dhe qëllimet e paraqitura në këtë strategji synojnë që në dy vitet e ardhshme Komuna e Podujevës të ketë statusin ekonomik dhe social, duke zhvilluar politika përkrahëse lokale për biznese, hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale, përmirësimin e shërbimeve publike, ofrimin e mundësive të barabarta në shkollim, jetesë të shëndoshë dhe të pastër për të gjithë qytetarët. Në esencë ky draft dokument është draftuar në mënyrë profesionale duke i vu politikat dhe instrumente në mënyrë selektive e jo ad hoc në planet dhe projektet që janë në interes të qytetarit në interes të biznesit si dhe fermerëve. Prandaj është e nevojshme krijimi i një sistemi dhe politike konsekuente ekonomike që do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik aktual dhe perspektiv të Podujevës.

Po ashtu Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal në mënyrë koncize bën skenimin e gjendjes aktuale, elaborimin e informatave të rëndësishme për të gjithë territorin e Komunës së Podujevës si dhe pozitën gjeografike, popullsinë, burimet njerëzore, tregun e punës, ekonominë, burimet natyrore, klima, trashëgimia kulturore, krijimin e një data bazë për të gjithë sektorët dhe Drejtoritë si dhe fokusimin në plane dhe projekte konkrete si: arsim, shëndetësi, infrastrukturë, kulturë, bujqësi, mjedisi etj. të cilat janë të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë platformë. Të gjitha këto elemente të vendosura dhe sublimura në mision dhe vizion që Komuna e Podujevës po bën përmes planit operacional për zhvillim të qëndrueshëm e që njëherit është edhe qëllimi i strategjisë. Meqenëse kjo Strategji fillon të funksionalizohet që nga viti 2016 dhe vazhdon deri në vitin 2018 në baze të projekteve dhe prioriteteve që Ekzekutivi ka vendosur, shpresojmë që të ketë trendë pozitive në të gjitha segmentet e parapara ku pas implementimit të plotë do të shihen treguesit në lëvizjet e tyre.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, nuk dua të zgjasë diskutimin rreth këtij draft dokumenti ngase i njëjti do të del edhe në debat publik me qytetarë ku do të dëgjohen edhe mendimet tjera jashtë këtij Kuvendi, mirëpo ajo që mua më bënë përshtypje është se ne të gjithë jemi në dijeni se çka do të thotë ky nocion, një Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal më e mirë sesa

që e kemi pasur deri tani. Në këtë dokument 70% janë përshkruar vetëm se, ku shtrihet Llapi, çfarë kafshë jetojnë, cilat biznese kanë qenë deri tani, mirëpo nuk është një dokument i cili do të tregonte se çka nuk kemi pasur deri në vitin 2016 dhe çka do të kemi deri në vitin 2018. Unë kam vërejtur disa projekte të Drejtorive përkatëse, shembull, blerja e një mamografi, projekt ky i cili ka qenë në projekte prej që ka filluar ky mandat, dhe mendoj se ky është vetëm një element i vogël në këtë dokument, konsideroj se drejtorët e Drejtorive sot nuk mund ta ndajnë strategjinë 2014 - 2016 nga kjo që është paraqitur për vitet 2016 - 2018 se cilat kanë qenë projektet e reja por vetëm është përshkruar dhe do të dëshiroja nga drejtori z.Avni Fetahu të na tregon se çka do të ketë Podujeva dhe qytetarët e Komunës së Podujevës në vitin 2018 e që nuk e kanë në fillim vitin 2016, andaj unë mendoj se Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal do të duhej të specifikonte këtë, dhe në këtë aspekt ne të gjithë e kuptojmë se strategji të zhvillimit që do të gëzonte qytetarët nuk do të kemi nëse nuk kemi partneritet publiko privat çështje për të cilën nuk ka specifikime sa i përket vitit dhe caktimit të pronave ku do të kishte një partneritet të tillë shumë të hapur dhe shumë demokratik me pjesëmarrje të biznesmen, kurse jemi në dijeni se të gjithë biznesmenët e Llapit kanë shkuar në komunat tjera dhe të cilët menaxhohen nga kryetarët e atyre komunave për shkak të ofrimit të kushteve që u janë bërë atyre biznesmenëve, pra biznesmenët më të fuqishëm deri në këto vitet e fundit kanë qenë Llapjan të cilët kanë qenë të detyruar të kalojnë me biznes në komunat tjera për arsye të mos ofrimit të kushteve nga Komuna jonë, qoftë të partneritetit publiko privat, qoftë të mos ofrimit të hapësirës nga ana e Ekzekutivit të Komunës. Kështu që unë mendoj se ky dokument do të diskutohet prapë në këtë Kuvend, mirëpo ka vërejtje të madha për arsye se nuk kemi specifikime të zhvillimit, kurse në anën tjetër figurojnë disa projekte të asfaltimit të rrugëve, shembull, asfaltimi i rrugës në fshatin Surdull e cila është kryer, por që mjete për atë rrugë janë ndarë edhe në mandatin e kaluar por edhe në këtë mandat, apo në sektorin e bujqësisë për të cilin ne të gjithë jemi në dijeni se e kemi një zhvillim i cili bëhet në bashkëpunim me USAID ku shpërndahen mjedra dhe sistem të ujitjes të cilat dikush i mbjell dikush jo, por nuk mund të themi se ka zhvillim të hapur, pastaj në sektorin e shëndetësisë nuk mund të themi se kemi zhvillim kur jemi në dijeni se materniteti që nga fillimi i këtij mandati është premtuar ndërtimi dhe funksionalizimi si spital. dëshiroj nga së paku një drejtor i një Drejtorie që në draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të na trego si e ka paraparë zhvillimin e vetë në fushën përkatëse dhe çka do të kenë qytetarët nga fushëveprimtaria e tij deri në fund të vitit 2018.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe i autorizuar për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, theksoi, siç jeni në dijeni kjo pikë e rendit të ditës është për t'ia dhënë vizën këtij dokumenti për diskutim publik, natyrisht sot mund të ketë sugjerime dhe vërejtje të ndryshme. Në vazhdim më lejoni të bëjë një përmbledhje të diskutimeve tuajat të cilat më ngjajnë sikur të diskutohej tani për Kornizën Afatmesme Buxhetore, dokument i cili është miratuar nga ju dhe ato projekte tani veç kanë kaluar procesin dhe nuk e kanë pasur vendin në këtë draft Strategji. z.Lutfi Rexhepi e tha se kjo Strategji nuk paraqet vizion dhe as qëllim, e që unë mendoj se i njëjti ka mundur të thotë se nuk pajtohet me vizionin dhe qëllimin, ngase është fakt i pa mohueshëm se drafti i Strategjisë paraqet vizion dhe qëllim, në të njëjtën kohë ne kemi paraparë prioritetet dhe masat konkrete bazuar në mundësit buxhetore të Komunës sepse nuk kemi mundur të parashohim projekte të cilat do të lireshin, siç e potencova më parë, si fontanë dëshirash. U tha se nuk ka përputhje

me projektet e parapara me Kornizën Afatmesme Buxhetore, gjë për të cilën mendoj se do të ishte mirë të gjendej ndonjë element që nuk ka përputhje dhe ne do ta përmirësonim atë, e them këtë sepse ne i kemi paraqitur në këtë dokument ato projekte të cilat kanë përputhshmëri me Kornizën Afatmesme Buxhetore por ka edhe projekte tjera të cilat janë paraparë me donatorë dhe të cilat janë të specifikuara.

Sa i përket znj. Adelinë Stublla e cila e tha se janë përshkruar të dhëna sa për t'i përmbushur 40 faqe, unë ju informoj se me këtë punë të bërë gjatë tërë vitit kemi përmbledhur saktësisht 165 faqe dhe ato i kemi shpërndarë në Drejtoritë përkatëse andaj nuk e kemi parë të rrugës që ta ngarkojmë Strategjinë me të dhëna, shembull, nga trashëgimia kulturore me rreth 20 faqe, por kemi vendosur që atë pjesë ta vendosim në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe ata të cilët dëshirojnë më shumë mund të drejtohen në atë Drejtori dhe të kërkojnë të dhëna më të gjëra, pra nuk kemi dashur ta ngarkojmë Strategjinë me të dhëna të shumta për arsye se nga përvoja ime kam hasur, shembull, Salzburgun kam pasur fatin ta vizitoj dhe kam parë se ka strategji të tillë edhe me 10 faqe, por ka hasur edhe në strategji edhe me 5 faqe, pra nuk do të thotë që ajo duhet të ngarkohet aq shumë, por duhet të përshkruhen prioritetet dhe masat konkrete. z. Flakron Gashi e potencoi çështjen rreth klimës të bërit biznes, ne të gjithë jemi në dijeni se kjo fillon nga niveli qendrorë, kurse ne si Komunë jemi munduar përmes One Stop Shop t'ju ofrojmë shërbime bizneseve dhe t'ju ofrojmë mundësi dhe lehtësira bizneseve në kuadër të kompetencave që ka Komuna, mirëpo sigurisht se jeni në dijeni se Komuna koncentrohet të krijoj kushte për zhvillim ekonomik lokal, por nuk mund të bënë ndonjë mrekulli në këtë aspekt. Sa i përket turizmit që z. Haki Rudari e ceku, ne kemi një dokument i cili aktualisht është i shtypur dhe një nga pjesët e atij dokumenti e kemi shkëputur dhe është i përfshirë në draft Strategji, mirëpo ajo që mund të them se kemi dokumente tjera të shtypura për turizmin ku një ndër ta është, Investo në Komunën e Podujevës, në të cilin përfshihen të gjitha ato elemente të cilat u përmenden.

Lidhur me atë që z. Rafet Llapashtica e tha se rreth 70% të dokumentit flitet vetëm për kafshë, mua më duket se nuk tingëllon mirë kjo ngase dokumenti është fakt dhe në atë vërehen efektet dhe masat konkrete për secilën Drejtori përkatëse, ndërsa sa i përket partneritetit publiko privat që u potencua nga disa parafolës, ne realisht duhet të bëhemi të sigurtë se kjo nuk ka treguar sukses në nivel të Kosovës, dhe është e natyrshme se një biznes mund të orientohet në kryeqytet për arsye se fuqia blerëse është më e madhe dhe është krejt e natyrshme që atë fuqi ta kanalizoj në një vend ku ka më shumë leverdi, dhe nuk mund askush të obligoj askënd.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, vetëm sa për sqarim, i nderuar drejtor mendoj se më keni keqkuptuar sepse unë në asnjë rast nuk e përmenda vizionin por mes tjerash e thash se ky dokument nuk mund të quhet strategji ose thënë ndryshe më së paku mund të quhet strategji, e thash se mund të quhet profil apo historik i Komunës. Nuk mund të quhet Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal sepse është një përmbledhje e dobët dhe e pasaktë e historikut të Komunës, dhe fundja është një copy past e Kornizës Afatmesme Buxhetore të cilën ne e kemi aprovuar në këtë Kuvend, e që draft Strategjia ka shpërputhje me projektet e miratuara në KAB dhe këtë mund të vërtetoni nëse krahasoni ato projekte me projektet e përfshira në këtë draft Strategji, prandaj në këtë aspekt autorët e kësaj Strategjie nuk kanë pasur kujdes që shumat e projekteve mes KAB dhe draft Strategjisë të jenë në përputhje mes vete.

z.Flakron Gashi, theksoi, drejtori ndër të tjera e tha se Komunat nuk mund të bëjnë mrekulli dhe për këtë ne të gjithë pajtohemi se Komuna nuk mund të bëjë mrekulli, mirëpo të paktën nga 332 kompani punuese që janë, më thoni një kompani të dytë përveç Vëllezërve Hyseni që ka shtruar vetëm një m³ kubëza në Komunën e Podujevës, dhe po kësaj kompanie nuk i mjafton vetëm me kaq por i punësohet edhe motra apo e bija e padiplomuar dhe jap mësim në shkollën e mesme.

z.Haki Rudari, theksoi, kur e përmenda vizionin, iu referova draft Strategjisë për të cilën jemi duke diskutuar sipas së cilës nuk i kushtohet vëmendje e madhe turizmit dhe në këtë drejtim në një mënyrë u dakorduat edhe ju si drejtor. Çështja tjetër është se ne vazhdimisht kemi kërkuar informata rreth gjendjes së pronave të Komunës, kurse në faqen 25 të draftit të kësaj Strategjie ndër të tjera thuhet, deri në fund të vitit 2016 do të bëhet inventarizimi i pronës komunale e që mund të jepen për nevoja ekonomike si dhe gjatë viteve në vazhdim do të përgatiten dhe do të ofrohen për punë bizneseve të cilat gjenerojnë punësim, shtrohet pyetja, qeveria komunale nuk është në vitin 2016 por kjo qeverisje është qe 16 vite dhe ku ishte deri më tani dhe ku janë masat e ndërmarra deri më tani, pra këto janë ato vërejtjet tona që i kemi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nuk është hera e parë që Kuvendi i Komunës së Podujevës miraton Strategji të tilla sepse janë miratuar në të kaluarën tri apo katër strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal. Çdo vërejtje, sugjerim apo plotësim ndryshim për të cilën mendoni se është me vend mund dhe keni të drejtë të paraqitni gjatë diskutimit publik, pastaj pas dy muajve ky dokument prapë do të vij në Kuvend për miratim final ku do të mund të inkorporohen të gjitha ato vërejtje, sugjerime dhe plotësime të cilat vlerësohen si me vend.

z.Mirsad Kamerolli, theksoi, vetë fakti që para vetës kemi draft Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal flet shumë, dhe nuk është mirë që nga disa ekspertë të jashtëzakonshëm që kemi në këtë përbërje të Kuvendit, këtë dokument ta shohin vetëm zi, mirëpo do të ishte mirë që vlerësimet të jenë reale dhe pozitive në përputhje me vlerat që ka ky dokument. Unë jam pjesë e këtij Kuvendi mandatin e kaluar dhe në këtë mandat, dhe ky Kuvend ka pasur opozitë edhe më të fuqishme se sa që është kjo tani, mirëpo kemi qenë konstruktiv sa i përket vlerësimeve ku në shumicën e rasteve kemi dhënë vlerësime reale pozitive. Pra konsideroj se nuk është mirë që ta torturoni këtë Kuvend duke përdorur platforma të cilat ju shërbejnë juve brenda partive tuaja.

z.Haki Rudari, theksoi, nuk jemi duke debatuar se çfarë opozitash ka pasur më përë në këtë Kuvend, por jemi duke debatuar për një Strategji, dhe nëse mundesh urdhëro shfletojë këtë dokument dhe gjejë diçka rreth turizmit, prandaj është mirë që secili të fol në emër të Grupit të këshilltarëve të cilit i përket, të kemi kujdes kur flasim për parti tjera.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bëri të marrë fjalën dhe të jem pjesë e diskutimit rreth kësaj draft Strategjie diskutimi i këshilltarëve paraprak rreth asaj që u tha se ky Kuvend gjithherë ka qenë funksional dhe ka qenë demokratik sa i përket pozitë opozitë. Kjo draft Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal si dokument bazik për orientimin e zhvillimit të Komunës është ashtu siç ne i qasemi, në këtë rast si opozitë nuk dëshiron ta shoh si dokument të vetin, e që në realitet çka do që del me miratim të këshilltarëve është dokument i Kuvendit ngase edhe opozita është pjesë e demokracisë komunale.

Deri tani dëgjova vetëm 2-3 propozime, ndërsa qysh në fillim u tha se ne sot mund të diskutojmë për një draft Strategji dhe për të cilën do t'i japim vizën që të del në diskutim publik, dhe vetë fjala draft Strategji dhe diskutim publik, e lenë hapësirën dhe ka mundësi

që çdo njëri prej nesh që ka diçka për t'i dhënë kësaj Strategjie që ajo të jetë më kuptimplotë sa i përket zhvillimit ekonomik të Komunës së Podujevës, dhe në këtë aspekt shpresoj shumë se gjatë diskutimit publik kjo Strategji do të pasurohet jo vetëm nga ne si këshilltarë të Kuvendit por edhe nga gjithë qytetarët e Komunës nga të gjitha lokalitetet dhe njëkohësisht kërkoj që ky draft t'iu ofrohet sa më shumë qytetarëve dhe sa më shumë të dëgjohet fjala e qytetarëve në mënyrë që qytetarët përmes kontributit të tyre në një mënyrë të inkorporohen dhe të jenë pjesë e kësaj Strategjie. Konsideroj dhe shpresoj se sot duhet t'i jepet viza për diskutim publik këtij drafti të Strategjisë në mënyrë që t'iu jepet mundësia e kontributit edhe atyre që mund të kontribuojnë, dhe në këtë aspekt ne Grupi i këshilltarëve, Grupi Plus do ta mbështesim.

z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, falënderoj ekipin i cili ka përgatitur draftin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018, po ashtu falënderoj këshilltarët të cilët gjatë diskutimeve paraqiten ide dhe pikëpamje të ndryshme lidhur me dokumentin.

E them këtë ngase do të ishte e pakuptimtë të thuhej se ky material i përmbush të gjitha kërkesat e një dokumenti në momentin e parë të paraqitjes së tij ngase i njëjti vihet në diskutim publik me qëllim që dokumenti final të jetë i plotësuar me të gjitha propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet me vend të cilat mund të jepen gjatë procesit, në mënyrë që pas miratimit në këtë Kuvend, Komuna e Podujevës ta ketë vërtetë një Strategji të Zhvillimit Ekonomik Lokal e cila i plotëson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe vërtetë të jetë një udhërrëfyes për punët tona. Sa i përket propozimeve që ne të marrim ide nga disa kryetar të komunave, nuk e besoj se ne kemi nevojë të marrim modele të tilla të cilat tani veç kanë filluar të shihen se janë të dështuara, ne kemi modelin tonë të qeverisjes të cilin e kemi paraqitur edhe para qytetarëve nga të cilët kemi marrë edhe besimin e tyre për qeverisje dhe sigurisht se do të vazhdojmë edhe në të ardhmen me këtë projekt.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me që diskutimet përfunduan rreth kësaj pike të rendit të ditës, unë e hedh në votim këtë propozim vendim për vënie në diskutim publik të draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018, debati publik me qytetarë të mbahet më 05 shkurt 2016, çështjet tjera janë të evidentuara në propozim vendimin përkatës, kurse nëse miratohet, draft Strategjia dhe Vendimi për diskutim publik publikohet në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Pas votimit u konstatua se me 33 vota për, 1 votë kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua propozimi i vendimit për vënie në diskutim publik propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2016-2018, duke përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa.

4. Informatë për përfundimin e suksesit të nxënësve në gjysëmvjetorin e parë dhe fillimin e gjysëmvjetorit të dytë të vitit shkollor 2015 – 2016

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, bazuar në planin e punës së Kuvendit të Komunës, Drejtoria e Arsimit ka përgatitur informatën e përkatëse të cilën e keni para vetës, andaj sipas Rregullores fjala hyrëse i takon drejtorit të Drejtorisë së Arsimit.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, duke paraqitur fjalën hyrëse, ndër të tjera veçoi, informata pasqyron të gjitha aktivitetet e punës edukativo arsimore të shkollave të Komunës së Podujevës duke u bazuar në kalendarin shkollorë 2015-2016, mandej vazhdon paraqitja e aktiviteteve dhe rezultateve të nxënësve nga përfundimin e gjysëmvjetorit të parë si dhe përgatitjet dhe fillimi i gjysëmvjetorit të dytë shkollorë.

Ndër të tjera në informatë paraqitet edhe një pjesë e suksesit të nxënësve sipas niveleve duke përfshirë notën mesatare e cila pasqyrohet edhe me grafik. Po ashtu janë të paraqitura edhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit vjetorë ku ndër të tjera janë edhe aktivitetet dhe veprimet të cilat ndërmerren për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe në ngritjen e arsimit në përgjithësi në Komunën e Podujevës, po ashtu në informatë janë paraqitur edhe profilet profesionale të mësimdhënies, vizitat, kontrollet, monitorimet dhe bashkëpunimin me institucionet relevante arsimore si dhe çështje tjera me rëndësi.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së i përkrahim veprimet konkrete të cilat i ka ndërmarrë Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës për ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në arsim, dhe atë, caktimin e koordinatorit komunal për cilësi, trajnimin i koordinatorit nga projekti i binjakëzimit, zhvillimin profesional të mësimdhënësve, organizimin dhe realizimin e trajnimeve për mësimdhënës mbështetur nga programi për arsim themelorë, po ashtu vlen të përsëriten edhe vizitat dhe kontrollet e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit së bashku me zyrtarët tjerë të arsimit dhe këshillat drejtues të shkollave me qëllim të fuqizimit dhe funksionalizimit të tyre dhe të njoftimit me prioritetet e të gjitha shkollave. Në si Grup i këshilltarëve kërkojmë që çdo herë e më shumë të punohet dhe të investohet në arsimin e Komunës së Podujevës.

z.Flakron Gashi, theksoi, bazuar në informatën që kemi pranë vetës, dërguar nga Drejtoria e Arsimit, kronologjia e rezultatit të mësimnxënies apo suksesit të nxënësve nga niveli 1 gjerë në nivelin 3 është shqetësues, nga kjo mund të vlerësohet niveli 1 me notën mesatare 4.34 e që në emër të subjektit Partia Demokratike e Kosovës i përgëzoj 4 shkollat fillore, "Musli Dumoshi", "Ali Ajeti", "Jahë Hasani" dhe "Jetullah Gashi" të cilat notën mesatare e kanë mbi 4. Nëse tani i referohem fjalës hyrëse të kësaj informate, aktivitetit i punës edukativo arsimore nuk del të jetë edhe aq edukativ ngase nivelet 2 dhe 3 kanë një ritëm të theksuar të rënies së suksesit në vend të asaj që duhet të rritej sukcesi, sa për të ilustruar këtë unë do të marr një shembull, kjo është e ngjashme sikur një njeri të lindej plak dhe gjatë jetës të fillon të zbriten vitet deri në etapën foshnje, që i bie e kundërta prej reales, pra një gjeneratë e fëmijëve tanë të mbaroj klasën e pestë me notën mesatare 4.34, ndërsa klasën e nëntë apo shkollën fillore me notën mesatare 3.8 dhe të vazhdoj me përfundimin e shkollës së mesme me notë mesatare 2.24, është diçka e tmerrshme dhe brengosëse për opozitën dhe ashtu duhet të jetë edhe për pozitën, dhe për këtë një pjesë të përgjegjesisë duhet të mbaj Drejtoria komunale e Arsimit.

Nota mesatare e tri shkollave të mesme të jetë vetëm 2.24, mendoj se nuk kërkon asnjë analizë, Gjimnazi me notën mesatare 3 ndërsa shkolla Teknike dhe ajo Ekonomike me 1.4

respektivisht 1.8, është shembull që ilustron përkushtimin tuaj për gjendjen në arsim. Pra i nderuar drejtor kjo është gjendja reale dhe nuk ka se si të jetë ndryshe kur nga vetë informata në fjalë tregon se nga 40 institucione shkollore të nivelit fillorë duke llogaritur edhe ato me paralele të ndara, deri tani ju keni vizituar vetëm 10 prej tyre dhe me këtë ritëm nuk do të mund të vizitoni as gjysmën e shkollave deri në fund të vitit shkollor, ose viti juaj shkollor apo akademik zgjatë 2-3 vite. Veprimet e cekura nga ju, të cilat do të ndërmerren me qëllim të ngritjes së cilësisë janë utopike me realitetin, sipas jush dhe sipas kësaj informate mungesa e rritjes së zhvillimit profesional të mësimdhënësve qenka arsyeja e suksesit të dobët, pse të mos vlerësohet performanca individuale por të targetohen të gjithë, përderisa të zgjedhni dhe të emëroni drejtor të shkollave sikur të jeni emisar politik dhe po ata drejtor ndaj stafit të ushtrojnë kontrole të linjës partiake, asnjëherë nuk do të ketë rezultate më të mira. Dhe për fund, politizimi i arsimit në Komunën e Podujevës, trajtimi jo i dinjitetshëm i personelit mësimdhënës, mundësia që të padiplomuarit të japin mësim, shkelja e Udhëzimeve Administrative dhe shkelja e Ligjeve për arsimin parauniversitar, punësimet pa konkurs janë dëshmi se ju në kontinuitet po e shkatërroni arsimin dhe vlerat e tij, madje i nderuar drejtor, askush nderë qytetarëve, nxënësve dhe mësimdhënësve, më shumë nuk do t'iu bënte se sa ju të jepni dorëheqje.

z.Haki Rudari, theksoi, është e vërtetë se ne si Grup nga radhët e LVV-së kemi kërkuar një informatë të tillë dhe e përshëndesim ardhjen e kësaj informate. Ajo që dua të them është se arsimi është në një gjendje jo të mirë duke përfshirë edhe në nivel të Kosovës, mirëpo ne do të ndalemi në nivel të Komunës së Podujevës. Gjendja e arsimit në Komunën e Podujevës është e rëndë që nga paslufta dhe kjo gjendje po realizohet përmes disa indikacioneve të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit. Sa i përket notës mesatare 2.24 në nivelin e 3-të tregon se gjendja e arsimit në shkollat e mesme është jo e mirë, sigurisht se ne që punojmë në arsim jemi në dijeni se ndjejmë një lloj të përgjegjësisë por mbi të gjitha përgjegjësia më e madhe bie mbi Drejtorinë e Arsimit. Informata në një mënyrë është e mirë por është edhe jo e plotë ngase mungojnë çështje të ndryshme të cilat në arsim janë të domosdoshme të përmenden, nuk përmenden sukseset e nxënësve, mungesat, sjelljet e nxënësve, po ashtu nuk përmendet infrastruktura sportive e shkollave ku realisht në shumicën e shkollave është në gjendje të rëndë, nuk përmenden kabinetet shkollore dhe bibliotekat, transporti i nxënësve më shumë se 4 km, pastaj mbetja e shumë nxënësve të shkëlqyeshëm me të gjitha 5-sa për një kohë të gjatë pa u regjistruar, nuk përmendet dhuna fizike në disa shkolla mes nxënësve dhe nuk përmendet as pranimi i kuadrit pa kriterë, andaj të gjitha këto bëjnë që arsimi në Komunën e Podujevës të jetë në gjendje jo të mirë. Emërimi i drejtorëve të shkollave duhet t'i paraprinë një kriteri për arsye se jemi në dijeni se drejtori është shembull për menaxhim të një shkolle, pastaj ka ndodhur organizimi i ekskursionit në Shqipëri me një çmim prej 100 € e që ne vazhdimisht kemi kërkuar sqarime pse ndodh kjo kur ne mësimdhënësit në pushimet verore shkojmë për një shumë prej 65 €, pastaj kemi mbetjen e më shumë se 1200 nxënësve të shkollës "Naim Frashëri" në shtëpi për shkak të rrënimit të shkollës, gjë e cila është dashur të përfshihet me një informatë të plotë se si ka ndodh kjo çështje, pastaj mungesa e lëndës djegëse për disa shkolla ku sipas informatave që kemi ne si Grup, Drejtoria e Arsimit ka borxhe për më shumë se dy vite në kompaninë ku furnizohet me naftë, prandaj gjendja e ngrohjes në disa shkolla është jo e mirë ku në mungesë të ngrohjes së disa shkollave nuk është zhvilluar mësimi fare. Pra mund të vijmë në përfundim se gjendja e arsimit nuk është e mirë dhe për këtë ne si Grup nga radhët e LVV-së propozojmë dhe kërkojmë nga Drejtoria e Arsimit dhe

nga të gjithë që të ndërmerren masa pozitive në mënyrë që të ngritët cilësia e arsimit në Komunën e Podujevës. Gjithashtu një çështje të cilën edhe në mbledhjen e KPF-së e kam përmendur, mendoj se Komiteti për Arsim i themeluar nga Kuvendi i Komunës është një trup ndihmës i cili ndihmon punën e Drejtorisë së Arsimit, andaj është mirë të inkorporohet, kyqet dhe të funksionalizohet, në Rregulloren për kompetencat e Komiteteve të Kuvendit ndër të tjera thuhet, Komiteti për Arsim ka të drejtë të shqyrton programin, punët dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon masa mbështetëse të tyre, kurse ne asnjëherë nuk kemi një gjë të tillë. Në këtë informatë përmendet edhe dhënia e bursave për nxënës dhe studentë por nuk përmendet shuma, nuk përmendet numri i tyre dhe nuk përmenden kriteret në bazë të cilave ndahen bursat, andaj konsideroj se Komiteti për Arsim sigurisht se do të kryente rolin e tij për arsye se është trup ndihmës që i ndihmon Drejtorisë së Arsimit në trajtimin e çështjeve të ndryshme duke përfshirë edhe transparencën sepse një Komitet i tillë i përbërë nga këshilltarë të subjekteve të ndryshme natyrisht se transparenca dhe llogaridhënia do të ishte më e mirë, prandaj kërkoj që Drejtoria e Arsimit në këtë drejtim të ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë që arsimit të mbetet aty ku është dëshirë e të gjithë neve.

z.Bahri Blakçori, theksoi, lidhur me informatën e cekur unë më tepër dëshiroj të ndalem rreth suksesit të nxënësve ngase çështjet tjera pothuajse i përmendi shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së z.Fidan Rekalii. Sa i përket suksesit të nxënësve në nivelin 1 ku nota mesatare është 4.34 e që mendoj se nuk ka arsye për të mos qenë të kënaqur, gjithashtu në nivelin 2 nota mesatare është 3.8 mendoj se është mbi mesataren e mundshme, gjithëherë duke pasur parasysh se është vetëm gjysëmvetori i parë i vitit ku nxënësit janë më pak aktiv, por mundësia që nxënësit të jenë më aktiv në gjysmëvjetorin e dytë është shumë më e madhe, sa i përket nivelit të 3-të ku nota mesatare është 2.24 sigurisht se ne do të dëshironim të ishte më e madhe por megjithatë është kjo që është. Marrë në përgjithësi nga niveli 1 deri në nivelin 3, nota mesatare është 3.22, andaj nuk kemi arsye shumë për tu brengosur sepse kjo mesatare për të tri nivelet, duke pasur parasysh se është vetëm gjysëmvejtori i parë, nuk është edhe aq brengosëse, dhe duke besuar se në gjysmëvjetorin e dytë interesimi i nxënësve do të jetë më i madh dhe nota mesatare do të ketë ngritje, këtë e them duke u bazuar edhe nga praktikat e mëhershme. Për fund, dëshiroj që drejtorit të Drejtorisë së Arsimit t'ia shtroj një pyetje në lidhje me objektin shkollorë afër shkollës "Enver Maloku" i cili ka filluar të ndërtohet në vitin 2009, projekt i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, pra në bazë të informatave që ka drejtori a mund të informoj se kur mund të përfundon ai projekt, dhe njëkohësisht propozoj që në shkollat e qytetit "Shaban Shala" dhe "Naim Frashëri" në kuadër të mundësive të provohet një model ndryshe dhe atë, niveli 1 (nga klasa I-V) të jetë në njërën shkollë kurse niveli 2 (nga Klasa VI-IX) të jetë në shkollën tjetër, fjala është për orarin, propozimi bëhet duke pasur parasysh afërsinë e shkollave që kanë mes vete, frekuentimin e nxënësve në një kohë por edhe numrin e nxënësve të të dy shkollave që afërsisht është i njëjtë, model i cili besoj se do të jetë i suksesshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, mendoj se rezultatet janë ato që janë dhe nuk mund të ndryshohen, por është brengosje kjo çështje, unë kam vizituar më shumë se dhjetë shkolla dhe do të mundohem që në këtë foltore të foli me gjëra konkrete dhe të të cilat janë realitet. Pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, ka përfunduar gjysëmvejtori i parë dhe rezultatet e notave kanë ardhur nga drejtorët e shkollave, unë personalisht kam vizituar shkollën "Luigj Gurakuqi" paralelja e ndarë te Lagja Nesusht ku kam kontaktuar me drejtuesit e

shkollës dhe me disa profesorë, një nga lëndët të cilën është dashur të figuroj në këtë informatë dhe që është dashur të prezantohet edhe mesatarja për lëndën e edukatës fizike e cila që nga tetori i vitit të kaluar nuk është mbajtur fare, dhe drejtori i emëruar nga ju me mjete të veta personale kishte blerë një tavolinë të pingpongut vetëm sa për të bërë një aktivitet për të mos u shuar krejt ajo lëndë, andaj i nderuar drejtor a mund të më tregosh se si janë notuar nxënësit e asaj shkolle në lëndën e edukatës fizike kur ajo lëndë nuk është mbajtur fare që pesë muaj dhe sigurisht se nuk do të mbahet deri në fund të muajit qershor. Çështja tjetër është se si mund të ndodh dhe a guxojmë të pajtohemi që në një shkollë fillore nxënësit që nga gjashtë vjet e deri ta përfundojnë shkollimin fillor vijojnë mësimet në një objekt shkollor që nuk ka tualet, ju mund të mos më besoni por mund të vizitoni secili nga ju shkollën “Luigj Gurakuqi” dhe do të bindeni në këtë që e them, gjithashtu të rrinë një nxënës i ciklit të ulët për rreth tetë orë pa ujë të pijes, dhe të detyrohen nxënësit që nga muaji tetor 2015 të mos e mbajnë orën e edukatës fizike, unë mendoj se po edhe në qoftë se ata nxënës notohen me nota pesë, konsideroj se prapë se prapë nuk është bërë asgjë, andaj lidhur me atë që parafolësi e tha se nuk është edhe aq shumë brengosëse gjendja e arsimit unë e them se secili nga ne nuk do të lënim fëmijët tanë të vijojnë mësimet në atë shkollë dhe në ato kushte. Duhet të arsyetohen 200,000.00€ të cilat ndahen për çdo vit për mirëmbajtje dhe renovime të shkollave, por është banalitet i madh për neve që një fëmijë të vijoj mësimet por të mos ketë ujë të pijes, të mos ketë ku të kryej nevojat fiziologjike dhe të mos ketë ku të mban orën përkatëse të mësimet. z.Flakron Gashi shumë mirë e kërkoj që vendimi më i mirë do të ishte dorëheqja e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, dhe ne nuk dëshirojmë që drejtori i Drejtorisë së Arsimit të emërohet nga subjektet tjera sepse është subjekti i cili ka fituar zgjedhjet dhe ka marrë obligim për udhëheqje me Komunën, mirëpo drejtori aktual z.Avni Maloku nuk mund të udhëheqë me Drejtorinë e Arsimit për shumë arsye, unë kam vizituar edhe shkollën ku drejtori i drejtorit të Drejtorisë së Arsimit ka qenë drejtor i shkollës për dhjetë vite para se të merrte postin e tanishëm dhe gjendja në atë shkollë është mjaft e rëndë dhe me mjete të mirëmbajtjes ndoshta që nga paralufta. Unë mendoj se për gjendjen e arsimit në Komunën e Podujevës drejtori i Drejtorisë së Arsimit ose duhet ta shqyrtoj pozicionin e tij ose të ndërmer masa konkrete për përmirësimin e gjendjes së arsimit.

z.Avni Ajeti, theksoi, sa i përket diskutimit rreth lëndës së edukatës fizike nga këshilltari parafolës z.Rafet Llapashtica, unë kam një pyetje për të, një nxënës a duhet të ketë dituri në teori se sa është gjatësia dhe gjerësia e një fushe të futbollit apo ai duhet të vrapoj për ta matur atë.

z.Rafet Llapashtica, përgjigje parafolësit, të gjithë ne e kuptojmë se çka është lënda e edukatës fizike, pra edhe është edukatë, që duhet të ketë dituri se sa me sa është një fushë e futbollit në këtë rast, por është edhe fizikë që nënkupton përgatitje fizike, për ata edhe është emëruar ashtu. Pra kushtet dhe kriteret e mbajtjes së lëndës edukatë fizike nuk i kam përcaktuar unë por janë përcaktuar me Ligj dhe akte nënligjore të miratuara nga niveli qendror.

znj.Mynavere Abdullahu-Krasniqi, theksoi, konsideroj se informata për përfundimin e gjysëvjektorit të parë dhe fillimin e gjysëmvjektorit të dytë të vitit shkollorë 2015/2016 për të cilën jemi duke diskutuar ne sot, praktikisht ne jemi ata që e kemi kërkuar një gjë të tillë. Në këtë informatë janë paraqitur kryesisht rezultatet e arritura të nxënësve për të tri nivelet shkollore si dhe janë paraqitur edhe aktivitetet të cilat faktikisht i ka ndërmarrë Drejtorja e Arsimit në vazhdimësi për gjysmëvjektorin e dytë. Konsideroj se informata e paraqitur është

mjaft e rëndësishme dhe paraqet gjendjen reale të arsimit në të tri nivelet, dhe në qoftë se ndalemi dhe i analizojmë të tri nivelet, përkatësisht niveli 1 me notë mesatare 4.35 mund të themi se është një rezultat i cili është afër notës së shkëlqyeshme dhe rezultat i cili i gëzon të gjithë qytetarët do të thoja, sa i përket nivelit 2 i cili arrin notën mesatare 3.8, unë vlerësoj se është një rezultat i kënaqshëm për këtë periudhë mirëpo rezultati si i tillë ka hapësirë që të përmirësohet në gjysëmvjetorin e dytë duke pasur parasysh se kushtet janë relativisht të mira në infrastrukturën e përgjithshme shkollore, ndërsa sa i përket niveli 3, për të cilin parafolësit e përmenden më shumë, meqë kemi një rezultat jo të kënaqshëm në krahasim me dy nivelet e para i sugjeroj Drejtorisë së Arsimit që përmes personelit të vetë dhe zyrtarëve komunal të jetë më afër atyre shkollave në mënyrë që deri në përfundim të vitit shkollorë të arrihen rezultate më të larta edhe pse në kuadër të aktiviteteve në vazhdimësi, që janë paraqitur edhe në informatë në funksion të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, po ashtu monitorimi i shkollave është edhe një faktorë shumë i rëndësishëm, gjithashtu zhvillimi profesional i mësimdhënies dhe mësimnxënies në kuadër të të cilit janë aktivitete të shumta, pastaj rikualifikimet në vazhdimësi, janë elemente shumë të rëndësishme nga të cilat besoj se në të ardhmen do të ndikojnë pozitivisht në procesin edukativo arsimor.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, lidhur me këtë temë dëshiroj që edhe unë të jap një kontribut timin, fillimisht më vie mirë që kur kemi të bëjmë me çështjen e arsimit interesimi është i dukshëm nga të gjithë që të japin propozime, sugjerime, rekomandime dhe pse jo edhe vërejtje. E përshëndes drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili me këtë informatë ka pasqyruar një gjendje reale pa u mundur të pasqyron një gjendje të cilën do ta dëshironim të gjithë e që në fakt nuk është. Ne duhet të jemi në dijeni se cilësinë e arsimit nuk e përbën një ose dy faktorë, por e përbëjnë shumë faktorë dhe disa prej tyre janë shumë të rëndësishëm, dhe atë, planet dhe programet, kurikula, tekstet shkollore, infrastruktura fizike shkollore, trajnimi i mësimdhënësve e tjera e tjera që janë faktorë dhe parakushte për një cilësi të mirë në arsim. Kur flasim për ngritje apo rënie të suksesit ne duhet të kemi pikë referuese, të kemi pikë krahasuese se me çka e krahasojmë me atë që e themi. Nëse ky rezultat krahasohet me gjysëmvjetorin e parë të vitit të kaluar shkollor atëherë është përafërsisht i njëjtë dhe nëse krahasohet me suksesin e nxënësve në nivel të vendit për gjysëmvjetorin e parë prapë del se përafërsisht është i njëjtë. Ekziston një traditë në Kosovë ku niveli 1 ka një rezultat shumë të mirë dhe në këtë aspekt unë dëshiroj të jem shumë i sqartë me ju, më vie mirë dhe i gëzohem notës mesatare 4.35 dhe uroj të jetë real sepse vlera nominale e vlerësimit nuk e tregon cilësinë dhe ne mund të themi se është rezultat i suksesshëm, por me rëndësi është se a është në të vërtetë reale ajo apo nuk është ai rezultat, e them këtë ngase niveli 1 ka të bëjë me një mësues dhe vërtetë mësuesi ka dëshirë që nxënësit e vegjël t'i motivoj dhe t'i nxis edhe me vlerësim më të madh se sa që mund të jetë realitet. Sa i përket notës mesatare në nivelin 2, do të thoja se është i kënaqshëm, ndërsa sa i përket nivelit 3, e që mesatarja është shumë më e ulët, janë arsyet se pse është ky nivel dhe ky rezultat në shkollat e mesme të larta, nga përvoja që kam për rreth 17 vite në arsim, kryesisht në gjysëmvjetorin e parë të një viti mësimdhënësit janë pak më rigoroz dhe më dorështrënguar në vlerësimin e nxënësve për disa arsye ku një prej arsyeve është që nxënësit t'i nxisin dhe t'i motivojnë që në gjysëmvjetorin e dytë të punojnë më tepër dhe të kenë një rezultat më të mirë, por fatkeqësisht ka raste ku edhe mësimdhënësit procesin e vlerësimit e përdorin edhe për disiplinim të nxënësve, dhe kjo është më se e ditur.

Unë i dëgjova me vëmendje edhe çështjet që shumica nga ju i cekët, ku me një pjesë edhe unë jam në dakord, por nuk mund të jem në dakord me disa nga ju të cilët pa pasur të dhëna ose vetëm me të dëgjuara madje edhe nga disa të cilët edhe vetë punojnë në arsim e të cilët thonë se mësimi është ndërprerë në disa shkolla, mandej thuhet nuk është mbajtur për shkak të mungesës së ngrorjes nëpër disa shkolla, e që në të vërtetë nuk kemi asnjë rast të tillë në Komunën e Podujevës, pra nuk janë të sakta ato që thuhet, ka pasur një ndërprerje për rreth dy orë për shkak të defektit të krijuar të pompave të nxemjes por jo për shkak të mungesës së lëndës djegëse, andaj për këshilltarët të cilët nuk posedojnë informata dera e Drejtorisë së Arsimit është e hapura në çdo qastë në mënyrë që të marrin informatat e sakta dhe ta dinë se nga 67 objekte shkollore që ka Komuna e Podujevës vetëm dy prej tyre përdorin si lëndë djegëse naftën, Çerdhja për fëmijë dhe shkolla "Zenel Hajdini" në fshatin Lupç, pra nuk qëndron fakti se gjoja mësimi është ndërprerë për shkak të mungesës së naftës apo siç u tha Komuna ka borxhe operatorit qe dy vite, ngase po të ishte ashtu, sigurisht se jeni në dijeni se në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nëse operatorit ekonomik nuk i paguhen obligimet sipas kontratës, pas 30 ditësh ai ka të drejtë të bëjë kërkesë në Ministrinë e Financave e që Departamenti i Thesarit drejtpërdrejt nga buxheti i Komunës e realizon atë pagesë, andaj informatat duhet të merren nga organet përkatëse e jo të merren nga persona të cilët nuk janë të informuar sa duhet për çështje të cekura.

Unë jam shumë i bindur se të gjithë ju jeni të interesuar dhe jeni bashkëpjesëmarrës jo vetëm sa i përket suksesit të nxënësve të Komunës së Podujevës por në përgjithësi me proceset arsimore që ndodhen në Komunë.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e falënderoj Nënkryetarin e Komunës i cili shumë mirë i sqaroi disa nga çështjet e ngritura, mirëpo për hirë të korrektesisë unë dua t'i jap disa sqarime, unë nuk kam dëshiruar t'ju mundoj me një informatë voluminoze, ju jeni në dijeni se çdo shkollë në fund vit apo gjysëmvetor bënë analizat dhe në bazë të tyre unë kam bërë krahasimin dhe analizimin e rezultateve me ato të vitit të kaluar ku në nivelet 1 dhe 2 kemi ngritje të suksesit për 0.21, ndërsa sa i përket nivelit 3, në krahasim me vitin paraprak kemi ngritje të suksesit për 0.48, përkatësisht 0.48 në Gjimnazin "Aleksandër Xhuvani", 0.16 në shkollën "Isa Boletini" dhe 0.9 në shkollën "Fan S. Noli".

Kur e thash më parë se kam pasur 10 vizita në shkolla, fjala ishte për 10 vizita me këshilla të shkollave në bazë të ftesave të drejtorëve të shkollave përkatëse, pra nuk bëhet fjalë për vizita të zakonshme ditore apo javore sepse një gjë të tillë ne e bëjmë sipas nevojave pothuajse për çdo ditë. Mund t'ju them se unë jam mirëpritur nga këshillat e shkollave në takimet e mbajtura ku siç jeni në dijeni këto këshilla janë mjaft të rëndësishme të cilat paraqesin nevojat, kërkesat dhe prioritetet e shkollës përkatëse dhe të nxënësve në përgjithësi, por kërkesat duhet të jenë të arsyeshme, e jo të ndodh të kemi kërkesa për sasi të kompjuterëve shembull e të tjera.

Sa i përket funksionalizimit të Komitetit për Arsim unë jam i gatshëm të bashkëpunoj me atë dhe konsideroj se nuk ka asgjë të keqe në këtë aspekt, kurse sa i përket ndarjes së bursave për student dhe nxënës, unë nuk kam paraqitur shuma ngase buxheti është miratuar nga ky Kuvend ku edhe sigurisht ka qenë edhe kodi për ndarjen e bursave.

Sa i përket pyetjes së z.Bahri Blakqori rreth ndërtimit të objektit të shkollës "Enver Maloku", është fakt se të gjithë ne jemi të brengosur rreth gjendjes së asaj shkolle duke mos përjashtuar edhe gjendjen e Gjimnazit "Aleksandër Xhuvani" për arsye se ai objekt i papërfunduar është duke mbajtur peng rreth 3000 nxënës, unë vetëm mund t'ju them se

Drejtoria e Arsimit vazhdimisht ka bërë dhe është duke bërë kërkesa në organin përkatës sa i përket objektit të cekur, ndërsa sa i përket propozimit të këshilltarit të cekur konsideroj se është mjaft i qëlluar që të bëhet ndarja e niveleve në dy shkollat e cekura dhe mendoj se në të ardhmen mund të bëhet një ndarje e tillë. Sa i përket asaj që z.Rafet Llapashtica e potencoj rreth lëndës së edukatës fizike, ne të gjithë jemi në dijeni për gjendjen e shkollave dhe unë vazhdimisht do të përqipem që në ato mese ku nevojat janë më të arsyeshme për rregullim apo ndërtim të terreneve sportive do të përfshihen në prioritete.

z.Flakron Gashi, theksoi, e falënderoj drejtorin parafolës për sqarimet e bëra, mirëpo mua më duket paksa absurde të thuhet se, kërkesat për kompjuter në shkolla janë fontanë dëshirash, unë nuk di se si mund të punohet për rreth 8 orë në ditë pa pasur një kompjuter në tavolinë, mirëpo mua më duket fontanë dëshirash kur një student i padiplomuar jep mësim nxënësve në një moshë afërsisht të barabartë, dhe fontanë dëshirash është, ta marrim si shembull, orët e praktikës profesionale në shkollën ekonomike nuk mbahen fare por në vend të asaj ore nxënësit ose nuk vijojnë në shkollë fare ose bredhin rrugëve dhe në kafiteri, dhe kjo ndodhë gjithnjë duke qenë në dijeni se ato orë mund të mbahen në kompani ose në qendra tregtare - afariste të cilat operojnë në Komunën e Podujevës.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, përgjigje parafolësit z.Flakron Gashi, i nderuar hiqeni nga fjalori dhe nga koka juaj që në shkollat e mesme të Podujevës ka mësimdhënës të padiplomuar, dhe kërkoj nga ju që ta faktoni atë që thoni. Ka mësimdhënës të moshuar të cilët janë me Shkollë të Lartë dhe të cilët janë para pensionit, por me shkollë të mesme nuk ka, dhe këtë harrojeni. Po ashtu ju mbeta borxh një sqarim rreth një zonjushe të cilës ia përmende emrin në diskutimin e juaj të mëparshëm, unë ju siguroj se ajo vajzë jo që është e diplomuar por e ka të kryer edhe masterin.

z.Flakron Gashi, theksoi, i nderuar drejtor, të gjithë ata të cilën nuk posedojnë një diplomë të shkollës së mesme, janë studentë dhe ka pasur raste kur të atillë që nuk kanë pasur diplomë të fakultetit kanë dhënë mësim në shkollat e mesme, gjë për të cilën ju si drejtor jeni shumë mirë në dijeni dhe nuk ke dal asnjëherë të demantoni këtë. Unë jam në dijeni se ju jeni i aftë të shkëlqeni Ligjet dhe Udhëzimet Administrative dhe jo vetëm që keni shkëlqer për vajzën tuaj e cila është punësuar pa konkurs në shkollën teknike "Fan S. Noli", por madje edhe sa ishe drejtor i shkollës "Enver Maloku" nxënësen tuaj si sociologe e ke angazhuar edhe në mësimdhënie në mësim klasorë, madje as me Udhëzime Administrative nuk parashihet që një sociolog të jap mësim nxënësve.

z.Haki Rudari, theksoi, u tha se Komuna nuk ka borxhe për derivate të naftës për ngrohje, e ceka këtë çështje sepse operatori i cili gjendet furnizues në fshatin Sekiraçë e ka thënë një gjë të tillë. Çështja tjetër, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, sa mësimdhënës punojnë në arsimin fillorë në Komunën e Podujevës të cilët nuk janë me profesion adekuat, çështje e cilat ndikon në cilësinë jo të mirë të arsimit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e përgëzoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për informatën, konsideroj se kjo informatë është reale. Sa i përket çështjeve të ngritura unë nuk do të lëshohem më shumë sepse u diskutua mjaft, mirëpo sa i përket Komitetit për Arsim mendoj se ai komitet është i themeluar dhe kur do që dëshiron mund të thirrë mbledhje dhe të mbajë ato pa kurrfarë problemi.

5. Propozimi i Raportit të punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2015

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para vetës keni një dokument në të cilin është paraqitur puna e Kuvendit të Komunës në këtë mandat me theks të veçantë është hartuar raport i punës së Kuvendit për vitin 2015. Andaj nëse ndokush ka diçka për të diskutuar mund të merrni fjalën lirshëm, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozim Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015

6. Të ndryshme

Nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 11;45

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-7384
Podujevë,
29 janar 2016**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**